




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 26 (1) (1.1) dhe neni 40 (5), në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2023, miraton:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 13/2023 PËR
FORMËN DHE PËRMBAJTJËN E LEGJITIMACIONIT**

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Udhëzim administrativ (këtu e tutje: Udhëzimi) përcaktohet forma, përmbajtja dhe procedura për pajisjen dhe përdorimin e legjitimacionit për zyrtarin e autorizuar për inspektim të konkurrencës (këtu e tutje: Zyrtari) në Autoritetin e Konkurrencës (këtu e tutje: Autoriteti).

Neni 2
Legjitimacioni

1. Legjitimacioni i Zyrtarit është e punuar si kartelë plastike në formë katërkëndshi, me dimensione 85mm x 55mm, sipas Shtojcës I.
2. Zyrtari gjatë inspektimit e mbanë legjitimacionin me vete.

Neni 3
Përmbajtja e legjitimacionit

1. Legjitimacioni në pjesën para duhet të përmbajë: fotografinë, emrin dhe mbiemrin, pozitën, numrin rendor dhe datën e skadimit të afatit të legjitimacionit.
2. Legjitimacioni në pjesën prapa duhet të ketë autorizimin që i mundëson zyrtarit qasje të lirshme të inspektimit në çdo kohë, nënshkrimin e kryetarit të Autoritetit dhe vulën e Autoritetit.
3. Pjesa para dhe prapa e legjitimacionit është shtojcë e këtij Udhëzimi.
4. Legjitimacioni duhet të jetë në gjuhët zyrtare.

Neni 4
Përdorimi i legjitimacionit

1. Legjitimacioni duhet të përdoret vetëm në fushëveprimin e autorizimeve ligjore të kryerjes së inspektimit të konkurrencës.
2. Për keqpërdorimin e legjitimacionit përgjegjës është bartësi i saj.
3. Është e ndaluar dhënia e legjitimacionit personave të tjerë në shfrytëzim.

Neni 5

Vlefshmëria e legjitimacionit

1. Legjitimacioni vlen nga dita e dhënies e deri në ditën e skadimit të saj.
2. Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës së zyrtarit në çfarëdo forme, ai obligohet të kthejë legjitimacionin tek eprori.
3. Legjitimacioni i kthyer asgjësohet.
4. Zyrtarit përkohësisht do t'i merret legjitimacioni nëse kundër tij ka filluar hetimi ose është ngritë aktpadia, për vepra penale që parashihet dënimi më tepër se gjashtë (6) muaj, deri në përfundimin e procedurës.

Neni 6

Humbja e legjitimacionit

1. Zyrtari që e humbë legjitimacionin, është i obliguar menjëherë të njoftojë eprorin e tij.
2. Legjitimacioni i ri do t'i jepet pasi që legjitimacioni i humbur të shpallet i pavlefshëm në shpallje publike.

Neni 7

Evidenca për legjitimacionin e dhënë dhe të kthyer

1. Për legjitimacionin e dhënë dhe të kthyer mbahet evidenca e cila është shtojcë e këtij Udhëzimi, Shtojca II.
2. Evidenca nga paragrafi 1 i këtij neni përmban:
 - 2.1. emrin dhe mbiemrin e zyrtarit,
 - 2.2. numrin e legjitimacionit,
 - 2.3. numrin e evidencës,
 - 2.4. datën e dhënies,
 - 2.5. datën e kthimit,
 - 2.6. datën e asgjësimit (nëse duhet të bëhet),
 - 2.7. nënshkrimi i zyrtarit,
 - 2.8. nënshkrimi i zyrtarit që mbanë evidencën dhe
 - 2.9. rubrika për vërejtje.

Neni 8

Ndryshimi dhe plotësimi i këtij Udhëzimi Administrativ

Ndryshimin dhe plotësimin e këtij Udhëzimi mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e tij.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Neime Binaku-Isufi

Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës



Shtojca I, sipas nenit 3: Përmbajtja e Legjitimacionit

Pjesa para

	<p>Republika e Kosovës <i>Republika Kosovo - Republic of Kosovo</i> Autoriteti i Konkurrencës <i>Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority</i></p>	
	LEGJITIMACION - LEGITIMACIJA	
F O T O	Emri / Mbiemri – Ime / Prezime: _____	
	Pozita / Položaj: _____	
	Nr. / Br.: _____	
	Data e skadimit / Datum isteka: _____	

Pjesa prapa

<p>A U T O R I Z I M</p> <p>Për hetimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me shkeljen e konkurrencës, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr.08/L-056.</p> <p>O V L A Š Ć E N J E</p> <p>Za istražu svih radnji koje se odnose na povredu konkurencije, na osnovu Zakona o Zaštiti Konkurencije Br.08/L-056.</p> <p>Kryetari / Presednik</p> <p>_____ Emri/Mbiemri-Ime/Prezime</p>

Shtojca II, sipas nenit 7: Evidenca për legjitimacionin e dhënë dhe të kthyer

Numri i evidencës	Emri dhe mbiemri	Numri i legjitimacionit	Data e dhënies	Data e kthimit	Data e asgjësimit	Nënshkrimi i zyrtarit	Nënshkrimi i zyrtarit që mbanë evidencën	Rubrika për vërejtje